



ALEKSANDËR PEÇI NË „KOHËN“ E SKËNDERBEUT

Mbas 60 Vjetësh Peçi shkruan një muzikë filmi për heroin tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu

“Kompozitorët kosovarë dhe krijimtaria muzikore folklorike”

Prof.dr.sc.Akil Mark KOCI

Kujtim Laro, njeriu që bëri histori në muzikën e filmi shqiptar

KRISTO KONO, “LULJA E KUJTIMIT” DHE OPERAT E TJERA TË TIJ

Jan Kukuzeli, muzikanti i madh durrsak

Nga Prof.Shyqri NIMANI



Fjala e redaktorit



DY PARADOKSE MUZIKORE

Prof.dr.sc.Akil Mark Koci

Sot në rubrikën Fjala e redaktorit do të flasim për dy paradokse muzikore.

Paradoksi i parë:

Duke e marrë parasysh universalizmin e veprave muzikore me të drejtë shtrojmë një pyetje: pse mungojnë veprat e kompozitorëve shqiptarë në manifestimet dhe në festivalet e muzikës së kultivuar në Kosovë?

Kemi thënë dhe shkruar disa herë se në festivalet që financohen nga Ministria e Kulturës dhe e Sportit prej mjeteve të tagrapaguesve për lloj-lloj manifestimesh kulturore, është interesante, flas për manifestimet muzikore, në Kosovë shumë pak ose aspak nuk kemi vepra që ekzekutohen nga ansamblet tona ose ato që vijnë nga jashtë si mysafirë.

Është mirë që ne në ato manifestime po njihemi me krijimtarinë e kompozitorëve që na i sjellin ansamblet pjesëmarrëse në manifestimet tona, mirëpo është absurde pse ato ansamble që marrin pjesë, nuk ekzekutojnë asnjë vepër të kompozitorëve shqiptarë qofshin nga Kosova ose Shqipëria, pos që ekzekutojnë veprat e atyre që i ftojnë në ato manifestime e ata janë të paktë.

Dikur nuk ka mundur me ardhë asnjë ansambël në Skenën Muzikore të Prishtinës në Ditët e Muzikës Kosovare, as në koncertet e rregullta të sezonit, sepse artistët e ardhur nga jashtë gjithmonë kanë qenë të obliguar ta ekzekutojnë ndonjë vepër të autorëve nga Kosova.

Ky paradoks shkaktohet nga qëndrimet e drejtorëve, të udhëheqësve artistikë të këtyre manifestimeve, të cilët nuk i intereson afirmimi i veprave të autorëve të tjerë pos i krijimtarisë së vet.

Këtu qëndron faji edhe tek institucionet që i financojnë këto manifestime. Ato duhet të kërkojnë përgjegjësi nga udhëheqësit e këtyre manifestimeve për lëshimet e këtilla, sepse nëse veprat e autorëve-kompozitorëve kosovarë nuk ekzekutohen në Kosovë, ku do të ekzekutohen atëherë veprat e tyre?!

Një pakice të vogël të kompozitorëve iu ekzekutohen veprat jashtë Kosovës! Ka ndodhur që veprat e udhëheqëse të Filarmonisë së Kosovës janë ekzekutuar në manifestime të këtilla, kurse veprat e autorëve të tjerë, që nuk nuk janë të paktë, me vite të tëra nuk ekzekutohen!

Kërkoj ndjesë për jomodestinë time, por kam vënë re se veprat e mia derisa ekzekutohen në botën e jashtme, si në Opati, Zagreb, Vjenë, Londër, Spanjë, Shqipëri dhe në shumë vende të tjera, në Kosovë Filarmonia e Kosovës, krahas saj edhe kori, çdo pesë vjet, me rastin e përvjetorëve të mi: 65, 70 dhe 75-vjetorin, më ekzekutohet nga një vepër!

Por kjo nuk ndodh vetëm me mua, po edhe me kolegët e tjerë. Prandaj institucionet përkatëse, të cilat i financojnë këto manifestime, duhet të kërkojnë përgjegjësi nga udhëheqësit mediokër, të cilët nuk çajnë kokën për këto punë!

Paradoksi i dytë:

Sot në Republikën e Kosovës, në shtetin tonë të ri, kemi disa shkolla të ulëta dhe të mesme muzikore, siç janë, bie fjalë, në Prizren, Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Mitrovicë, Gjilan dhe në disa vende të tjera, të cilat shkollojnë kuadro, mirëpo aktiviteti i këtyre shkollave sikur nuk është në nivel të duhur. Pos koncerteve gjysmëvjetorëshe dhe në fund të vitit, nuk zhvillojnë kurrfarë aktivitete të tjera. Se, ku janë, ta zëmë, garat e solistëve, të koreve dhe të orkestrave, ku janë koncertet në qytetet e afërta të tyre, ose pse nuk marrin pjesë në garat jashtë shtetit tonë! Çka punojnë arsimtarët në shkolla fillore dhe të mesme, nëse nuk ekzistojnë kori dhe orkestra, si i plotësojnë normat e tyre? Por për hir të së vërtetës duhet të pohojmë se aty-këtu paraqitet ndonjë kor dhe orkestër, por aktiviteti i tyre duhet të jetë më i madh, sepse ata janë edukatorë të gjeneratave të reja për muzikën në përgjithësi e sidomos për muzikën e kultivuar, e cila na mungon. E kemi për detyrë që si e vetmja revistë muzikore në të gjitha trojet shqiptare, ta shfaqim mendimin tonë në lidhje me këto dy paradokse muzikore. E themi për hir të së vërtetës se në botën e muzikës sonë diçka po lëviz, po megjithatë kjo çka pondodh - nuk është e mjaftueshme

Aleksandër Peçi në „kohën“ e Skënderbeut

Mbas 60 Vjetësh Peçi shkruan një muzikë filmi për heroin tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu



Eriona RUSHITI

Kompozitore, Pedagoge
Universiteti i Arteve



Në një kohë kur të gjithëve na ka kapluar „lajmi i parë“, apo „lajmi i fundit“, në shtypin e shkruar, dhe në siglat rrëqethëse televizive: rreth të përditshmes kaotike, rreth rrëmujës, rreth „ngjarjeve në bulevard“ rreth spektakleve garuese vokale, rreth thirrjes për të luajtur me fatin e mospasjes e për të fituar një makinë, e shumë e shumë kronikash të zeza e të nxira...rreth kaq shumë episodesh jetësore që hyjnë e dalin nga ne duke lënë gjurmë e njolla trishtimi, të cilat cdo ditë e më tepër na pengojnë frymëmarrjen natyrale, dëgjojnë tinguj që formojnë një temë, e që shoqërohet me një informacion që lajmëron shfaqjen e një filmi dokumentar „Skënderbeu“ me regji të Vladimir Priftit, pjesëmarrjen e aktorëve të vyer të kinematografisë shqiptare e muzikë të kompozitorit Aleksandër Peçi.

Ndaloj...nuk e di as vetë...për t'iu larguar kësaj të përditshmeje, apo për të gjetur rrënjët e saj... Menjëherë më vjen ndër mend filmi epiko-historik i vitit 1954 (bashkëprodhim shqiptaro -rus), me regji të Sergei Yutkevich dhe me një kastë aktorësh (ku po vecoj ata shqiptarë) si Besa Imami, Naim Frashëri, Adive Alibali, Marie Logoreci, të cilët më kishin magjepsur dikur si fëmijë, tek e shihja filmin për herë të parë. Unë atëherë nuk i dija, nuk i njihja cmimet internacionale, por më vonë kuptova rëndësinë e realizimit të tij, i cili për nga vlerat historike, sekuencat masive të aksionit, lojës së shkëlqyer të aktorëve kishte gjetur vlerësim po në atë vit në festivalin e filmit në Kanë (International Price).

Dëgjoj këmbanën që lajmëron vdekjen e Skënderbeut... por që mund të jetë edhe këmbanë paqejë... sipas historisë...Kështu nis muzika e krijuar sot, në 2012 nga kompozitori Aleksandër Peçi për këtë dokumentar.

Kanë kaluar rreth 60 vjet, aq sa mban mbi supë edhe kompozitori Aleksandër Peçi që të shkruaj muzikë

film për prijësin kalorësiak Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Peçi ka qenë i sapo lindur atëherë, kur babai i muzikës shqiptare Cesk Zadeja me shkollim në Rusi do të krijonte së bashku me homologun e tij rus Sviridov atë muzikë heroike që shoqëronte të gjitha skenat madhështore luftarake. U deshën 60 vjet që figura e heroit tonë legjendar të risillet për ne me fakte të reja historike dhe me veshjen e re muzikore....

Gjithmonë e kam menduar që edhe pa qenë e nevojshme të shihen imazhet muzikale e krijuar për një film të sjell menjëherë në kohën dhe vendin në të cilën zhvillohen ngjarjet, të vijëzën personazhet, heroin, të kujton episode të ndryshme... thjesht dhe vetem duke dëgjuar disa tinguj, të cilat identifikojnë lehtëazi një film. Dhe kjo më ka ndodhur sa herë kam dëgjuar në radio melodicitetin që karakterizon muzikën e shkruar nga Peçi për filmin „Në cdo stinë“, Në shtëpinë tone, Kur xhirohej nje film, Dasma e Sakos. Jam gjendur në të njëjtën situatë kur kam dëgjuar e ri-dëgjoj vajtimin e klarinetës në filmin „Gjeneral gramafoni“, ku lotët e një fëmije i kthen menjëherë në ngulcime pikërisht kjo muzikë e krijuar nga Peçi. Pra, të shkruash muzikë për një film është si të skicosh personazhin, të realizosh ngjarje nëpërmjet tingujve, e cila krijon një simbiozë me të gjithë komponentët e filmit. Dhe këtë çelës nuk e kanë aftësinë apo dhuntinë ta gjejnë të gjithë krijuesit e muzikës. Duhet të hysh thellë në brendinë e

personazhit, duhet të gesh burimin e cdo veprimi apo të zbulosh në detaje psikikën e një personazhi. Dhe ndjej të më përcillet fare bukur e qartë me tingëllim fyejsh intonacione të një kënge dibrane për të më përafuar me vendin ku lindi dhe kaloi fëmijërinë e tij, në Sinë, Gjergji i Kastriotëve. Pak e dinë dhe e njohin këtë fshat të Dibrës (gati i panjohur), i cili gjëmon nga legjendat, e që studimet e thella në memorandumën e Gjon Muzakës (bashkëkohës i Skënderbeut dhe kushëri i së shoqes -Donikës) na çojnë në këtë fshat mes malesh të Peshkopisë dhe origjinën e tij, megjithëse shumë zona në Shqipëri e pretendojnë atë. Këta fyej bjeshkësh për të përshkruar lindjen e Skënderbeut 607 vjet më parë në këtë zonë, formojnë një ninullë që përkund të ardhmen dhe historinë e mëpastajme. Jo rastësisht Peçi inspirohet nga folklori i kësaj zone, sepse kërkon të theksojë dhe të shuajë cdo hamendësim politik e mediatic të qarqeve të caktuara që synojnë ta kthejnë Skënderbeun një herë në turk, një herë në sllav e një herë në grek. Kjo ninullë do të trajtohet në fund të filmit si një vaj me nota te forta dramaciteti e dhimbjeje për humbjen e këtij miti legjendar, që i kapërceu kufijtë shqiptarë, do të fuqizohet nga trompat, do të derdhë lot violinash e harqesh, do të krijojë një harmoni të trishtë dhe do ta copëtojë ritmin, ashtu sic copëtoi zemrat e një kombi të tërë. Do të shoqërohet me një vokal mashkullor bas profundo të shtrirë,

Pas një krijimtarie kaq të gjatë e të ngjeshur (duke botuar një sasi jashtëzakonisht të konsiderueshme partiturash muzikore rreth 560 tituj botimesh) pa frikë Aleksandër Peçi do ta quanim - kalorsiaqu i muzikës shqiptare bashkëkohore,

e të rëndë, kë nduar nga basi i talentuar në Akademinë e Arteve - Ariol Xheferi, për të na përcjellë lash-tësinë e legjendës.

Dhe ja diku teksa flitet për nënën e tij Vojsavë, motrën Mamicë për gruan Donikë dhe religjionin kristian bashkëtingëllojnë zërat femëror që duket se mbajnë në buzë tingujt kishtarë që shoqërohen nga prekjet e një harpe, nga një melodi unisone që të duket se të kthen me shekuj larg...aq e ndjerë kjo melodi baroke e krijuar nga autori (frymë zim i punimeve në stil Bach që Peçi eksperimenton me studentët e kompozicionit) sa të duket sikur Aleksandër Peçi të ketë jetuar në atë kohë...

Diku nga mesi i filmit luan një kuartet harqesh që duket se përshkruan një kuvendim burror...një dialog të gjatë, por të paqte, me linja të ndërthurura që i lënë kohë njëra-tjetrës të shprehen, ashtu sic ka ndodhur në mbledhjen e parë të princave shqiptarë në Kuvendin e Lezhës 1644, i cili vendosi mbrojtjen e trojeve tona nga pushtuesit otomanë: Bashkimi i shqiptarëve në një dhe Skënderbeu kryeprijës i tyre. Peçi duket që zotëron të gjitha mjetet shprehëse për të krijuar dramaturgjinë e muzikës, të cilë n ai e ka kompozuar me të njëjtin impenjim jo si të ish një film dokumentar, por si një krijim që kërkon angazhimin e filmit të gjatë artistik. Në të shumtën e rasteve dokumentarë t nuk sjellin një krijim të mirë filltë muzikor, por i gjejnë me muzikë ilustrative, e ndoshta është rasti i parë në kinemanë shqiptare që dokumentari fiton vlera të reja, me një muzikë kaq të realizuar e të shkruar enkas për të. Është kjo një arsye dramaturgjike - muzikore që Peçi nxitet të shkruajë e të ndërthurë bukur momente sonore të intrigës, ku tingujt përplasen e dizonojnë me njëri-tjetrin.

Sa herë që flitet për fitoret e njëpasnjëshme të heroit tonë Skënderbeu, i cili me t' u kthyer në vendlindje, në vendin e Kastriotëve, së bashku me kalorësit e tij krijon beteje pas beteje mitin e triumfit, nuk

mund të mos pulsojnë në dëgjim trokëllitjet e kuajve, përplasjet shpatore, pluhuri që ngrihet pas gjurmëve që lënë pas të rënë në luftë. Një kreshendo që përfshin një orkestër të tërë e që kulmon me tunxhin si për të na treguar që këto mbeten ndoshta 25 vitet më të lavdishme shqiptare, kreshendo që të con drejt Krujës ku ngrihet për herë të parë flamuri shqiptar. Përplasen kambanat, dëgjohej një tekst vokal që duket sikur thotë: sot, sot, sotnis një temë luftarake e ndërthur mbi bazë kuartash e të gjitha këto krijojnë një shtresëzim të ngjeshur muzikor që të merr me vete drejt një kulminacioni e që më pas të lënë të dëgjosh qartazi temën e filmit „Skënderbeu“, të shkruar rreth 60 vite më parë nga Zadeja, si për të revokuar e provokuar memorien tonë me këtë temë që na ka rritur.

I gjithë ky krijim, cdo mendim i shndërruar në tinguj, ndërthuret mjeshtërisht me gjuhën e re muzikore që përdor sot kompozitori Aleksandër Peçi, i cili ka zënë një vend të konsiderueshëm në arkivin e muzikës shqiptare, jo vetëm për sasinë, për cilësinë, por edhe për shumëllojshmërinë e muzikës që ai krijon, duke prekur cdo gjini e zhanër, duke bërë të tijën në mënyrë fare organike tingëllimin bashkëkohor, mjetet shprehëse avangarde e gjithçka e re që vesh hijshëm gjuhën folklorike nga kemi ngjizur. Me inteligjencë kompozicionale midis citimeve nga filmi „Skënderbeu“ i vitit 1954 (që regjisori Prifti kish zgjedhur si materiale filmike) dhe muzikës që Peçi kompozoi, u arrit të krijohet unitetin i të tërës, pra uniteti muzikor në film në këtë rast shërben edhe për unitetin e të gjithë veprës filmike. Por nuk do të mjaftonte për një realizimin të tillë mjaft cilësor vetëm eksperiencia kompozicionale e Aleksandër Peçit, pa bashkëpunimin me producentin e muzikës, djalin e tij pianist e kompozitor Elvis Peçi në studion e tyre AELFIOR. (AELFIOR me 2 ambiente regjistrimi është sot në Shqipëri studioja më profesionale e më e specializuar për krijimin film - muzikës dhe e të gjitha zhanreve nga më të voglat e deri tek gjinitë më të mëdha si Baleti, Opera etc.

Pas një krijimtarie kaq të gjatë e të ngjeshur (duke botuar një sasi jashtëzakonisht të konsiderueshme partiturash muzikore rreth 560 tituj botimesh) pa frikë Aleksandër Peçi do ta quanim - kalorsiaqu i muzikës shqiptare bashkëkohore, që lufton cdo ditë për të tërhequr rreth vetes krijues të rinj, lufton cdo ditë që të bëhemi pjesë e integritit duke ngjitur në skena botërore premiera muzikore që mbajnë vulën Peçi, lufton cdo ditë për të ndikuar në politikën kulturore shqiptare, duke rrokur e theksuar gjithnjë e më tepër idenë e kombëtares.